



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:117872
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05370951

CA.nr.521/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Bujar Muzaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.D., nga Ferizaj, Rr. "R..... B.....", nr.XX, të cilin me autorizim e përfaqëson M.I., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurve EB R..... SH.P.K dhe EB C....., me seli në Ferizaj, Rr. "T.....", të cilët me autorizim i përfaqëson F.Sh., avokat F., me bazë juridike pengim posedimin dhe propozim për masë të sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me numër 2023:117873 të datës 13.09.2013, në seancën e kolegjit e mbajtur me datë 22.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurve EB R....., SH.P.K dhe EB C....., me seli në Ferizaj, Rr. "T.....", **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me numër 2023:117873 të datës 13.09.2013, dhe çështja i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

'I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit N.D., nga Ferizaj, e ushtruar kundër të paditurve EB R..... SH.P.K dhe EB C....., me seli në Ferizaj "T.....", ashtu që **VËRTETOHET** se të paditurit EB R..... SH.P.K dhe EB C....., me seli në Ferizaj "T.....", me datën 13.05.2023 e kanë penguar paditësin Nexhat Dauti nga Ferizaj në posedim të qetë të paluajtshmërisë së tij dhe atë duke e mihur dheun për hapjen e themeleve në parcelën fqinje, ashtu që në mënyrë të vrazhdë kanë dëmtuar objektin e paditësit të ngritur në NK.nr. XXX-2 ZK-Ferizaj, duke dëmtuar pothuajse tërësisht materiale izolues në themelet e objektit të tij, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat ligjore.

II.DETYROHEN – të paditurit EB R..... SH.P.K dhe EB C....., që paluajtshmërinë e paditësit me nr të ngastrës kadastrale nr. XXX-2 ZK-Ferizaj ta kthejnë në gjendjen e mëparshme ashtu siç ka qenë para shkaktimit të pengimit – trazimit dhe këtë ta bëj në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim e pasojave ligjore- përmbarimit të detyrueshëm.

III.OBLIGOHEN – të paditurit që në mënyrë solidare t'ia paguajnë shpenzimet procedurale paditësit dhe atë në shumën prej 640.⁰⁰€, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

IV.SHPALLET INKOMPETENTE – Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, për gjykimin e çështjes në pikëpamje lëndore sipas propozimit të paditësit N.D., kundër të paditurve EB R..... SH.P.K dhe EB C....., lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit.

V. Sa i përket pikës V të këtij dispozitivi, pasi që ky aktvendim të bëhet i plotfuqishëm, lënda t'i dërgohet Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuar i të paditurve në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar ankesën e të paditurve si të bazuar, aktvendimin ankimor ta ndryshon në atë mënyrë që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar, ose lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Ankesa e të paditurit i është dërguar për përgjigje në ankesë të autorizuarit të paditësit, mirëpo i njëjti nuk e ka dhënë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se: Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 25.05.2023 ka parashtruar padi kundër të paditurve, me bazë juridike pengim posedim ndërsa me parashtrësën e datës 22.08.2023, dhe në fjalën përfundimtare ka bërë propozim për caktimin e masës së sigurisë. Në padi dhe gjatë procedurës paditësi ka theksuar se të paditurit gjatë hapjes se themeleve në ngastrën fqinje e kanë dëmtuar objektin e paditësit në mënyrë të vrazhdë duke e dëmtuar izolacionin e themeleve dhe instalimin e drenazhës, të cilat dëmtime sipas ekspektimit plotësues mund të sanohet për arsye të sipërfaqes se vogël ndarëse, vetëm në qoftë se për këto punime intervenohet menjëherë. Më tutje ka theksuar se duke marrë parasysh këto fakte, është e arsyeshme dhe e bazuar kërkesa e paditësit e bërë më datë 22.08.2023 që në anën e paditurve të caktohet masa e sigurisë ashtu që atyre do t'i ndalohen vazhdimet e punimeve në ngastrën kadastrale XXX - 0 ZK Ferizaj deri në momentin kur dëmtimet e larte përshkruara do të sanohen dhe nuk kthehet gjendja ashtu siç ka qenë para veprimin të paditurve. Me këtë veprim të paditurit në mënyrë serioze e kanë penguar paditësin në posedimin e qenë të objektit të tij, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia dhe propozimi për caktimin e masës së sigurisë të aprovohet si i bazuar si dhe të detyrohet në mbulimin e shpenzimeve të procedurës. Gjykata e

shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe bazuar në dispozitat ligjore nga neni 103, 113 par. 1 të LPDTS, lidhur me nenin 480 të LPK, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Vendimin mbi shpenzimet procedurale e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me këtë çështje kontestimore ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni neni 182 paragrafi 2, pika n), lidhur me nenin 253 dhe neni 99 të LPK-së, të cilat kanë qenë me ndikim qenësor në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktvendimit ankimor. Këto shkelje qenësore shprehen në faktin se padia e paditësit lidhur me të cilën gjykata e shkallës së parë ka gjykuar me aktvendimin ankimor nuk e përmban kërkesëpadinë e kuptueshme për sa i përket vërtetimit të ekzistimit të aktit të pengimit në posedim, mënyrës së kryerjes së këtij akti nga ana e të paditurit. Padia e paditësit nuk ka qenë e rregulltë pasi që kërkesëpadija në pikëpamje të çështjes kryesore nuk ka qenë e caktuar plotësisht dhe lidhur me këtë gjykata nuk ka mundur të gjykoj, këtë sepse paditësi me padinë e paraqitur në gjykatën e shkallës së parë me datë 25.05.2023, në kërkesëpadi ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri ka bërë pengimin e posedimit të paditësit, në atë mënyrë që të paditurit kanë filluar punimet në ndërtimin e objektit të tyre afarist-banesor në ngastrën fqinje dhe gjatë punimeve mihjes së dheut për formimin e themeleve, është dëmtuar objekti i paditësit dhe atë pjesa izoluese e themeleve, dhe ka kërkuar që të paditurit menjëherë të ndërprejnë çdo veprimtari në drejtim të ndërtimit, me kërkesën e tillë të paditësit, nuk është sqaruar në mënyrë të plotë privimi i kundërligjshëm i posedimit, se është fjala për pengim posedim apo shkaktim dëmit.

Përveç kësaj, kolegji vlerëson se dispozitivi i aktvendimit ankimor është i pakuptueshëm dhe kontradiktor pasi që në pjesën e parë është vërtetuar se të paditurit e kanë penguar paditësin duke e dëmtuar objektin e paditësit të ngritur në ng.kad.nr.XXX-2 ZK Ferizaj, ndërsa në pjesën e dytë i ka obliguar të paditurit që këtë palujtshmëri ta kthejnë në gjendjen e mëparshme ashtu siç ka qenë para shkaktimit të pengimit - trazimit, në afatin e përcaktuar nën kërcënimin e pasojave ligjore, dispozitivi i tillë është kontradiktor dhe i pakuptueshëm, sepse tani më nuk dihet se a është konstatuar dëmi i shkaktuar i cili edhe është vlerësuar përmes ekspertizës së ekspertit vlerësues të datës 31.07.2023, apo se në rastin konkret kemi të bëjmë vërtet me pengim posedim. Ndërsa pika katër e dispozitivit të aktvendimit ankimor del të jetë edhe më kontradiktore kur gjykata shpallet jo kompetente për të vendosur në pikëpamje lëndore lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, kur të njëjtën e ka lejuar në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes. Meqenëse, aktvendimi ankimor i përmban shkeljet e sipërcekura, për këtë arsye është prishë dhe çështja i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Sipas dispozitës së nenit 7 pika 1 parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta bëjë eliminimin e shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të ndërmarrë veprimet e duhura procedurale për të orientuar zgjidhjen e rregullt dhe të drejtë të çështjes në atë mënyrë që të evitohet paraprakisht mangësitë procedurale - gjegjësisht të evitohet prezumimet procedurale negative që ndërliken me rregullsinë e padisë në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që do ta ftoj të autorizuarin e paditësit që brenda afatit ta bëjë precizimin e kërkesëpadiës duke caktuar plotësisht kërkesëpadinë, që ka të bëjë me aktin e pengimit të posedimit apo se çështja ka të bëjë me kompensim e dëmit, e cila çështje kontestuese duhet të zhvillohet sipas dispozitave të përgjithshme të procedurës kontestimore, ndërsa po ashtu gjykata është e detyruar që të vendos edhe lidhur me masën e sigurimit siç përcaktohet me dispozitat e nenit 297 të LPK-së.

Vendimi i gjykatës duhet t'i përmbahet kërkesave të LPK-së, nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5, në atë mënyrë që në arsyetim të vendimit gjykata të arsyetoj të gjitha rrethanat që kërkohen sipas përmbajtjes që përcakton LPK-ja, për arsyetimin e vendimit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 parg.1 pika (d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.521/2024, me datë 22.02.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti d.v,